



Tiranë më 04.05.2020

Frikë JO Përfaqësim PO

Viti 2020 është një vit ku në universitetet publike do të sprovohej **Demokracia** e brendshme e universiteteve. Në këtë vit studentët dhe stafi akademik do të zgjidhnin drejtuesit e rinj të universiteteve siç janë “ Dekan “, “Rektor” dhe “Senati Akademik”.

Për ne **DEMOKRACIA** si e vendit por dhe ajo universitare është shumë e rëndësishme dhe e shenjtë. Por ajo ruhet vetëm duke zbatuar ligjet.

Në vendimin e datës 30.04.2020 i nxjerrë nga Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) i Universitetit të Tiranës është shkelur neni 38 i RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DREJTUESE NË SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E TIRANËS" ku në pikën 1, gërma b shkruhet shprehimisht se zgjedhjet mund të anulohen në rast se:

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të atilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Pra siç shihet qartas kjo pikë është shkelur nga KIZ.

Parimi tjetër kryesor në **DEMOKRACI** në një proces zgjedhor është informimi i të gjithë votuesëve për procesin që në këtë rast janë studentët. Në kanalet e nëndheshme po dëgjojmë që informimi por edhe votimi i studentëve do të bëhet në mënyrë elektronike pasi ata nuk janë fizikisht në auditore.

Dimë që Kuvendi vendosi zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri më 23 Qershor. Kurse ministria vendosi rikthimin e studentëve që diplomohen në qershor, ndërsa për të gjithë studentët e tjerë më 25 Gusht, gjë që dukshëm rezulton auditore bosh në kohe zgjedhjesh .

Për arsye të shkeljes së rregullores dhe për shkak të privimit të së drejtës së informimit, votimit, por dhe të së drejtës për të bërë fushatë zgjedhore, ne e konsiderojmë jo të drejtë vendimin e dhënë nga KIZ i cili sa më parë duhet të terhiqen nga kjo rrugë e gabuar që kanë ndërmarë .

Ne kërkojmë:

1. Shtyrjen e procesit zgjedhor deri në kthimin e të GJITHË studentëve në auditore

Ne jemi në pritje të një reflektimi nga ana juaj në lidhje me këtë vendim të pakonsultuar në menyrë që studentët të mund të përfaqësohen denjësisht.

*Singerisht,
Studentët Tuaj*